



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 6 shkurt 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Ardian Gjini dhe Amir Ahmeti.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- ZPRK; Artan Canhasi – EULEX; Lejla Selimi – OSBE; Isuf Zejna – KDI dhe Eroll Gashi – student.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi- kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.01.2012;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-89 për deminim humanitar;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e tretë të hiqet nga rendi ditës.

Rend i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.01.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16. 01. 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare dhe kishte vërejtje për amendamentin 4 dhe 5. Përmbajtja e këtyre amendamenteve iu referohet neneve 2.3; 2.4 dhe 5. 23, të ligjit bazik dhe kjo nuk është objekt i Projektligjit dhe bie ndesh me procedurat e nismës legislative dhe Rregulloren e Kuvendit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamenteve 4 dhe 5. Përmbajtja e këtyre amendamenteve iu referohet neneve 2.3; 2.4 dhe 5. 23 , të ligjit bazik dhe kjo nuk është objekt i Projektligjit dhe bie ndesh me procedurat e nismës legislative dhe Rregulloren e Kuvendit.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, përveç amendamenteve 4 dhe 5, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët, që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Nuk kishte vërejtje në raportin e Komisionit FunkSIONAL nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-89 për deminim humanitar

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin për deminim humanitar dhe kërkoi nga anëtarët, që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Nuk kishte vërejtje në raportin e Komisionit Funksional nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-89 për deminim humanitar, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional, e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se dëgjimi publik për Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës do të mbahet më 7 shkurt 2012, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi